



UDHËZUES PËR METODOLOGJINË DHE NDËRHYRJEN NË ZHVILLIMIN E FËMIJËRISË SË HERSHME

Nëntor 2019



Ky udhëzues është përgatitur në kuadër të projektit "Rritja e Ndërhyrjeve në Fëmijërinë e Hershme në Kosovë", financuar nga Republika e Bullgarisë, menaxhuar nga Ambasada e Republikës së Bullgarisë në Kosovë dhe implementuar nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF dhe organizata "Karin Dom Foundation".

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen e "Bulgarian Development Aid". Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton pikëpamjet e "Bulgarian Development Cooperation" dhe Republikës së Bullgarisë.

Foto:

www.pexels.com

Në kuadër të projektit, KOMF ka zhvilluar një proces të vlerësimit të nevojave bazuar në nevojat e OJQ-ve anëtare dhe partnerëve të KOMF, në mënyrë që të zhvillojë kapacitetet në fushën e fëmijërisë së hershme në Kosovë.

Gjatë procesit të vlerësimit të nevojave, u organizua një punëtori me palët kryesore të interesit ku është analizuar korniza ligjore dhe raportet lidhur me fëmijërinë e hershme. Në procesin e vlerësimit të nevojave janë angazhuar organizata anëtare dhe partnerë të KOMF, përfshirë përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, institucioneve parashkollore dhe organizatave të shoqërisë civile që punojnë në fushën e zhvillimit të fëmijërisë së hershme.

Bazuar në Raportin e Vlerësimit të Nevojave, u organizua një trajnim tre-ditor për anëtarët dhe partnerët e KOMF me temë: Zhvillimi në Fëmijërinë e Hershme, i udhëhequr nga Zvezdelina Atanasova dhe Andreas Andreou, trajnerë në Qendrën e Trajnimit të organizatës “Karin Dom Foundation” nga Varna, Bullgari.

Ky manual jep udhëzime për metodologjinë dhe ndërhyrjen në zhvillimin e fëmijërisë së hershme në Kosovë.

Për përgatitjen e këtij udhëzuesi janë përdorur materiale të trajnimit të siguruara nga Universiteti i Oregon, SHBA, raporti përmbledhës nga Emily Vargas-Baron, Instituti RISE, 2018, materiale nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Rrjeti Kombëtar për Fëmijët dhe UNICEF, module trajnimi, broshura, raporte dhe udhëzime metodike të organizatës ‘Karin Dom’, Varna, Bullgari.

Ky manual është përgatitur nga : Zvezdelina Atanasova, “Karin Dom” Foundation, Varna, Bullgari
zatanasova@karindom.org

Konsulente: Magdalena Tsoneva , Fondacioni “Karin Dom”, Varna, Bullgari

PËRVOJAT NDËRKOMBËTARE TË NDËRHJRJES NË FËMIJËRINË E HERSHME (NFH)

Baza ligjore për Ndërhjrje në Fëmijërinë e Hershme e paraparë me legjislacionin ndërkombëtar:

“Mbështetja për fëmijën nga zhvillimi para lindjes deri në moshën tetë vjeç është e nevojshme në mënyrë që të realizohet e drejta e fëmijës për mbijetesë, mbrojtje dhe kujdes, gjë që do t'i garantojë atij zhvillimin më të mirë. Arsimit dhe kujdesi janë të lidhura në mënyrë të pandashme me lindjen e fëmijës: Klasifikimi Ndërkombëtar i UNESCO-s përcakton arsimin që në fëmijërinë e hershme si ‘nivelin 0’, domethënë si një nivel bazë të niveleve arsimore.

“Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të përfitojnë ndihmën e duhur nga një specialist dhe mbështetje për prindërit e tyre.

/Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës/

“Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë fëmijët të kenë qasje në zhvillimin cilësor që në fëmijëri të hershme, kujdes dhe edukim parashkollor në mënyrë që ata të jenë të gatshëm për arsimin fillor.” Kjo përfshin fëmijët e cenueshëm, me vonesa në zhvillim, me aftësi të kufizuara dhe çrregullime në sjellje.

Shërbimet e ndërhjrjes në fëmijërinë e hershme janë thelbësore për të siguruar që të gjithë fëmijët të arrijnë potencialin e tyre të plotë!

/Programi për Zhvillim të Qëndrueshëm i Kombeve të Bashkuara 09.2015/

Çfarë është Ndërhjrja në Fëmijërinë e Hershme?

NFH është përcaktuar si një sistem ndërdisiplinor, ndërsektorial dhe i koordinuar i shërbimeve individuale dhe intensive për prindër dhe fëmijë (nga 0 deri në regjistrimin në sistemin arsimor) të cilët janë fëmijë të cenueshëm, me vështirësi në zhvillim, me aftësi të kufizuara dhe çrregullime në sjellje, ose fëmijët që kanë nevojë tu ofrohet kujdes për shëndetin mendor.

Ndërhjrja në fëmijërinë e hershme përcaktohet si ofrimi i mbështetjes për familjet e foshnjave dhe fëmijëve dhe dhënie e mbështetjes për të pasur qasje në burime të disponueshme për të përmirësuar zhvillimin e fëmijëve dhe jetën familjare.

Ndërhjrja e hershme është e natyrës parandaluese.

Argumentet për rritjen e investimeve në faza të hershme të jetës:

Argumenti biologjik - cenueshmëri më e lartë gjatë zhvillimit të organeve vitale. Fëmija përvetëson modele biologjike dhe sjellje që janë të vështira për t' i kthyer mbrapsht.

Argumenti shoqëror - Pabarazia fillon herët dhe ka tendencë të rritet me kalimin e kohës. Ndërhjrja e hershme është mënyra më efektive për të ulur nivelin e zhvillimit të pabarazisë në shëndet dhe në arsimim të hershëm.

Argumenti ekonomik – Investimi në fëmijëri të hershme, ka përfitim afatgjatë. Kujdesi i mirë në fëmijëri të hershme përmirëson jo vetëm aftësitë kognitive, por edhe ndërveprimet sociale dhe emocionale.

Nëse investohet në fëmijërinë e hershme, fëmijët do të kenë status më të mirë social dhe shteti do të ketë shpenzime më të vogla për shoqërinë për shërbimet shëndetësore, sociale dhe drejtësi.

/ Rrjeti Kombëtar për Udhëzimet e Fëmijëve, Përmbledhje e Politikave dhe Praktikave të NHF/

Parimet e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme:

Parimi i parë është që shërbimet duhet të fillojnë nga mosha më e hershme e mundshme/mosha ideale është që nga lindja/në mënyrë që të rriten efektet e mundshme të ndërhyrjes dhe të zvogëlohen efektet e neglizhencës dhe mungesës së veprimit.

Parimi i dytë është që shërbimet të ofrohen në ambientin familjar të fëmijës (zakonisht në shtëpi) për të siguruar zhvillimin e aftësive që më pas mund të transferohen dhe përdoren lehtësisht në një ambient tjetër.


Parimi i tretë është që shërbimet të ofrohen përmes një qasjeje me familjen në qendër, ku profesionistët dhe familjet punojnë së bashku si partnerë të barabartë.

Parimi i katërt është se ofrimi i suksesshëm i shërbimeve përfshin ndërtimin e partneriteteve midis sektorëve, programeve dhe individëve të ndryshëm.

Ndryshime të rëndësishme në zhvillimin e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme në 25 vitet e fundit në nivel global



Tabela 1

Modeli i shërbimeve në programet e zhvillimit të fëmijërisë së hershme në British Columbia, Kanada / Diagrami A /**Komponentet e Sistemit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme në Oregon, SHBA:**

1. Identifikimi i fëmijëve: identifikimi dhe referimi, ekzaminimi, vlerësimi, përcaktimi se a ka nevojë për përfshirjen në program
2. Hartimi i një plani individual duke përdorur vlerësime funksionale
3. Ofrimi i shërbimit - caktimi i ekipit, vendndodhjes, metodave
4. Monitorimi i progresit - rishikimi i planit, qëllimeve dhe rezultateve
5. Plani i kalimit në shërbime të tjera - identifikimi i burimeve të disponueshme, përgatitja për tranzicion

NDËRHYRJA NË FËMIJËRINË E HERSHME NË BULLGARI KONTEKSTI NË BULLGARI

NFH filloi të zhvillohet në Bullgari në një kohë kur procesi i deinstitutionalizimit (reformimit) ishte në rrugë e sipër. Përparësi iu dha mbylljes së institucioneve për fëmijë 0 deri në 3 vjeç dhe nevojës për shërbime alternative në komunitet. Modeli i ekspertëve për ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara ishte i përgjithshëm, ku si pasojë fëmijët nga 0 deri në 3 vjeç me probleme zhvillimi kanë mbetur jashtë vëmendjes - nuk i janë nënshtruar një identifikimi të hershëm dhe një mbështetjeje të hershme të zhvillimit.

Në vitin 2010, me mbështetjen e organizatës 'Open Society Foundations - Early Childhood Development Program', me seli në Londër, nisi një Program Partneriteti midis organizatës 'Karin Dom' dhe Komunës Varna, Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve të Komunës Varna, shtëpive të maternitetit, konsulentëve për gjidhënie, këshillimoreve dhe kopshteve të fëmijëve.

Organizata 'Karin Dom' përfitoi shpejt përvojën e duhur. Familjet e regjistruara në program vlerësojnë efektivitetin e shërbimit dhe përfitimet për zhvillimin e fëmijëve dhe kapaciteteve, njohurive dhe shkathtësive të tyre. MPMS e pranoi shërbimin e Ndërhyrjes së Hershme të Karin Dom si praktikë e mirë dhe ia besoi zhvillimin e një Udhëzuesi Metodologjik për ofrimin e shërbimit Ndërhyrja e Hershme tek Fëmijët me Aftësi të Kufizuar, përmes krijimit të një Qendre për Ndërhyrje të Hershme për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar – 2014 (Figura 2). Si dhe trajnimin e Qendrave të sapohapura për Ndërhyrje të Hershme tek Fëmijët me Aftësi të Kufizuar në 46 qytete të vendit (Figura 1). Materialet për informim janë zhvilluar dhe janë shpërndarë në komunitet në formë broshurash, fletushkash për shërbimin e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme / Figura 3 /.

Shërbimet për Ndërhyrje në Fëmijërinë e Hershme në Bullgari për fëmijë nga mosha 0 deri në 7 vjeç ofrohen nga:

- Pesë OJQ që punojnë me fëmijë të moshës nga 0-3, 0-4, 0-7 vjeç;
- Strukturat shtetërore dhe komunale nën udhëheqjen e MPMS-së;
 - Qendrat për shërbime sociale të integruara për fëmijë dhe familje;
 - Qendrat për mbështetjen e komunitetit.



Figura 1



Figura 2



Figura 3

Bashkëpunimi me shërbime të tjera:

- Shtëpitë për kujdesin shëndetësor dhe social dhe shërbime të tjera të ofruara brenda tyre, nën udhëheqjen e Ministrisë së Shëndetësisë;
- Shërbimet për deinstitutionalizim, parandalimin e institucionalizimit, nxitjen e strehimit familjar dhe mbështetjen për adoptim, nën drejtimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Këshillimoret nën udhëheqjen e Ministrisë së Shëndetësisë;
- Kopshtet e fëmijëve, grupet parashkollore nën udhëheqjen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës;
- Qendrat private dhe OJQ të tjera.

Shërbime plotësuese: Klinikat dhe praktikat mjekësore, spitalet, spitalet e maternitetit dhe njësitë e kujdesit intensiv neonatal, vizitat mjekësore në shtëpi.

Partnerët: Shoqata Pediatrike e Bullgarisë, Rrjeti Kombëtar për Fëmijë, UNICEF, Asociacioni Kombëtar i Komunave në Republikën e Bullgarisë, Grupet dhe Shoqatat e Prindërve, Fondacioni Oak, Universitetet, Kuvendi Kombëtar, Avokati i Popullit i Republikës së Bullgarisë.

Diagrami 4

Si është i organizuar Shërbimi i Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme nga “Karin Dom”:

**Grupi i synuar**

Familjet që kanë fëmijë të moshës 0 – 3 vjeç të cilët janë:

- të rrezikuar nga zhvillimi i ndonjë aftësie të kufizuar, përfshirë foshnjat me lindje të parakohshme ose foshnjat me peshë të ulët të lindjes;
- me ngecje në njërin nga fushat e zhvillimit - kognitive, motorike, komunikuese, sociale, emocionale;
- të diagnostikuar me aftësi të kufizuar.

Çfarë ofron Programi i Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme?

- Vizita në shtëpi/familje
- Grupe të organizuara të fëmijëve për të zhvilluar lojëra dhe aktivitete të ndryshme, Ndërhyrja nga Ndërmjetësimi/Mediatorët në familje
- Grupe për mbështetjen e prindërve
- Një bibliotekë me pajisje ndihmëse, lodra dhe literaturë
- Mbështetje për gjidhënie

Konsulentët në ekipin e Programit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme janë ekspertë të specializuar në profesionet e mëposhtme:

- Psikolog - 1
- Logoped - 2
- Rehabilitator /kinezoterapist -1
- Punëtor social - 1
- Konsulent i jashtëm për gjidhënie -1
- Këshillohet që të keni edhe një pediatër në ekip

Njohuritë dhe aftësitë e specialistëve janë të integruara në mënyrë që ata të punojnë si konsulentë dhe jo si ekspertë.

Ne punojmë duke përdorur qasjen “Familja në Qendër”.

Konsulentët kanë:

- Njohuri teorike dhe përvojë praktike
- Shkathtësi vlerësimi
- Aftësi për të punuar me familje
- Aftësi në ofrim të shërbimeve
- Njohuri për fushëveprimin e programit
- Zhvillim profesional
- Etikë profesionale
- Cilësi personale
- Cilësi që nuk janë të obliguara por janë të dobishme, të tilla si qëndrueshmëria ndaj kushteve të ndryshme atmosferike, fleksibiliteti, aftësitë logjistike dhe të ngjashme.

Partnerët e Karin Dom:

Komuna e Varnës, këshillimoret dhe kopshtet e fëmijëve, Departamenti i Mbrojtjes së Fëmijëve, Spitali i Maternitetit ‘Prof. Dr. D. Stamatov’ - Varnë, Spitali Rajonal ‘Shën Anna’ - Varnë, shoqata “Colorful Future Association - Breastfeeding Support Consultants”, Qendrat e Strehimit Familjar, OJQ-të vendore.

Monitorimi dhe vlerësimi i Programit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme

Baza e të dhënave gjenerohet përmes një sistemi elektronik të dizajnuar posaçërisht për nevojat e programit.

Fokus grupet bëhen me partnerë dhe anëtarë të ekipit.

Intervistat dhe anketimet bëhen me prindër, profesionistë mjekësor, kopshte, këshillimore, institucione komunale dhe anëtarë të ekipit mbi kënaqshmërinë e tyre, përfitimet dhe sfidat e shërbimeve.

Të dhënat e monitorimit shpalosen publikisht përmes ngjarjeve mediatike, broshurave dhe publikimit të raporteve.

REKOMANDIME PËR ZHVILLIMIN E NDËRHYRJES NË FËMIJËRINË E HERSHME NË KOSOVË

Organizimi dhe menaxhimi i punës në Ndërhyrjen në Fëmijërinë e Hershme është thelbësor për funksionim efikas dhe efektiv të proceseve. Përmes përshkrimit të proceseve të punës, ndërtohet një model i strukturuar nga i cili do të ofroheshin shërbime për ndërhyrjen në fëmijëri të hershme në vend.

Elementet kryesore të një sistemi kombëtar të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme:

- Sigurimi i një kornize ligjore për sistemin e NFH-së përmes hartimit të një Ligji për NFH dhe/ose hartimit të një Plani Strategjik dhe një Plani të Veprimit për zhvillimin dhe zbatimin e sistemit të NFH-së;
- Zhvillimi dhe miratimi i udhëzuesve dhe procedurave kombëtare për NFH;
- Hartimi i standardeve për shërbime dhe staf.

Sistemi kombëtar i NFH-së duhet të ndërtohet mbi kapacitetet e shërbimeve ekzistuese të fëmijërisë së hershme dhe në bashkëpunim me shërbimet përkatëse.

- Qeveria cakton një ministri përgjegjëse për udhëheqjen e procesit të zhvillimit të sistemit për NFH, si dhe ministri të tjera që do të bashkëpunojnë ngushtë me të;
- Rekomandohet partneritetet me ministrinë e tjera dhe përfshirje e tyre në aktivitetet e planifikimit të sistemit për NFH;
- Bashkëpunimi në nivel lokal;
- Bashkëpunimi me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve;
- Bashkëpunimi me OJQ-të.

Procesi i planifikimit strategjik për Ndërhyrje në Fëmijërinë e Hershme kalon në disa hapa kryesorë:

- Përcaktimi i një ministrie udhëheqëse dhe ministrive të tjera që punojnë ngushtë me të;
- Themelimi i një grupi teknik ndër-sektorial për NFH;
- Përgatitja e një analize gjithëpërfshirëse të situatës në lidhje me NFH;
- Mbajtja e seminareve dhe konsultimeve publike për të rishikuar dhe finalizuar politikat dhe instrumentet në nivel qendror dhe lokal;
- Zhvillimi i intervistave me zyrtarët e lartë në të gjitha nivelet;
- Përgatitja e instrumenteve të politikave;
- Miratimi dhe zbatimi gradual i instrumenteve, deri sa të arrihet shtrirja e plotë në nivel vendi;
- Ministrinë dhe/ose Kuvendi nacional miratojnë dhe monitorojnë zbatimin e dokumenteve ligjore dhe strategjike.

Kuadri rregullator ligjor i sistemit kombëtar për Ndërhyrje në Fëmijërinë e Hershme

Është me rëndësi jetike rregullimi ligjor i shërbimeve të integruara për NFH-në. Në mënyrë që të kemi shërbime të integruara, është shumë i rëndësishëm hartimi dhe miratimi i Ligjit për NFH-në dhe/ose përfshirja e shërbimeve në dokumentet normative të ministrisë udhëheqëse, si dhe ministrive që punojnë në partneritet.

Udhëzuesit dhe procedurat për NFH janë të nevojshme për të krijuar një bazë gjithëpërfshirëse për Sistemin Kombëtar të NFH-së.

Si rrjedhojë, duhet gjithashtu të miratohen standardet për shërbime dhe staf për NFH.

Në ekipin e konsulentëve për Ndërhyrje në Fëmijërinë e Hershme mund të ketë specialistë nga fushat e mëposhtme:

- Psikolog
- Logoped
- Rehabilitator/Kinezoterapist
- Terapist kurdo që është e mundur
- Punëtor social
- Bashkëpunimi me konsulentë për gjdhënie
- Këshillohet që të keni një pediatër në ekip
- Ndërmjetësues/mediator sipas nevojës për komunitete specifike

Bazuar në nevojat e familjeve, mund të ketë më shumë se 1 specialist për fushën e njejtë në kuadër të ekipit. Njohuritë dhe aftësitë e specialistëve janë të integruara në mënyrë që ata të funksionojnë më tepër si konsulentë sesa si ekspertë.

Transporti sigurohet për vizita të ekipit në shtëpi. Nëse është e nevojshme, caktohet një shofer dhe sigurohet një veturë për të udhëtuar në adresat e largëta.

Konsulentët që punojnë në shërbime të NFH duhet të kenë cilësi profesionale dhe personale:

- Njohuri për përmbajtjen dhe fushëveprimin në fushat e zhvillimit të fëmijëve (aftësitë motorike globale dhe fine, gjuhët receptive dhe ekspresive, zhvillimin kognitiv, socio-emocional si dhe kujdesin për veten);
- Njohuri për etiologjinë dhe karakteristikat për çrregullimet në zhvillimin e fëmijërisë;
- Të kuptuarit se si ndikon aftësia e kufizuar në funksionimin dhe nevojat e fëmijës dhe familjes;
- Aftësi për të vëzhguar, mbledhur informacionin e nevojshëm dhe për të analizuar zhvillimin e fëmijës në mjedise të ndryshme ku fëmija e zhvillon ekzistencën e tij;
- Njohuri dhe aftësi për të përdorur instrumente të ndryshme vlerësimi: teste, përfshirë testet vlerësuese; vlerësimi i vazhdueshëm i fëmijës dhe vlerësimi i nevojave të familjes;
- Aftësi për të interpretuar informacionin e mbledhur dhe prezantuar atë tek prindërit ose profesionistët e tjerë;
- Aftësi për të aplikuar qasjen me familjen në qendër, të respektojnë të drejtën e familjes për të bërë zgjedhje kur merren vendimet dhe të tregojnë gatishmëri për të punuar në partneritet;
- Njohuri për marrëdhëniet familjare dhe për ndikimin e aftësisë kufizuar në familje;
- Respekt ndaj familjes, duke reaguar me kohë dhe tolerancë ndaj kulturave të ndryshme, religjionit, përkatësisë etnike dhe rrethanave tjera specifike të familjes;
- Aftësi për të dëgjuar dhe komunikuar me familjen me një gjuhë të kuptueshme, të kenë empati, të ofrojnë mbështetje, të inkurajojnë dhe këshillojnë kur është e nevojshme;
- Qasje dhe teknika të përshtatshme në aktivitetet e përditshme të fëmijës;
- Identifikimi dhe përdorimi efektiv i pikave të forta të familjes;
- Mbështetja e familjes në përcaktimin e qëllimeve për zhvillimin e fëmijëve të tyre;
- Njohuri për shërbimet e tjera të mundshme në komunitet dhe informimi i familjeve;
- Njohuri për objektivat e Programit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme, që përfshin: objektivat dhe parimet e programit; audiencën e synuar; kriteret e kualifikimit; dokumentacionin e nevojshëm; procedurat për regjistrim në program dhe largim nga programi; standardet e punës.
- Ngritja e kapaciteteve dhe aftësimi profesional përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe shkëmbimit të praktikave;
- Njohuri mbi hulumtimet shkencore, metodat terapeutike dhe qasjet e duhura në fushën e zhvillimit të fëmijërisë së hershme;
- Pjesëmarrja në aktivitete profesionale, hulumtime, shkëmbim përvojash etj.;
- Zhvillimi i procedurave për vetëvlerësim, plan të zhvillimit personal dhe mbikëqyrje profesionale të rasteve në punë;
- Respektimi i parimit të konfidencialitetit;
- Respektimi i parimit të mosdiskriminimit: ofrimi i shërbimeve të këshillimit/mbështetjes për të gjithë personat e përfshirë në program, pa marrë parasysh statusin socio-ekonomik, higjienën dhe kushtet e jetesës, nivelin e arsimit, racën, përkatësinë etnike dhe religjionin;

- Tolerant dhe të respektojë diversitetin;
- Shkathësi në punë ekipore: të shkëmbejnë informacion, të kërkojnë mbështetje shtesë, të bëjnë delegimin e aktiviteteve, të shfaqin respekt të ndërsjellë, të kontaktojnë me institucione dhe agjenci të tjera kur është e nevojshme;
- Adaptimi ndaj ndryshimeve në planet e punës, orareve ose nevojave të familjeve;
- Bashkëpunimi me prindërit dhe profesionistë të tjerë;
- Trajtimi i fëmijës në mënyrë holistike;
- Trajtimi i fëmijës si anëtar i familjes së tij/saj;

Rekomandojmë të punoni me qasjen Familja në Qendër

Përmbledhje e shkurtër e historikut:

- Carl Rogers, psikolog, ishte i pari i cili kishte folur për nocionin e qasjes "Familja në Qendër" – 1951;
- Prindërit presin vendimet e specialistëve (vitet 1950-1970);
- Prindërit janë të trajnuar dhe trajnerë (1970);
- Prindërit llojnë për të drejtat e fëmijëve të tyre.

Qasja me familjen në qendër është jetike për shërbimet e ndërhyrjes në fëmijëri të hershme. Ndërhyrja e hershme vë në pah burimet, e jo mangësitë, duke u bazuar në pikat e forta të fëmijës dhe familjes.

Familja është një partner i barabartë me specialistët që ofrojnë shërbime gjatë ndërhyrjes në fëmijëri të hershme.

Praktikat me familjen në qendër:

- Filozofia, parimet dhe praktikat për shërbime për fëmijë dhe familje që e vendosin familjen në qendër të shërbimeve, luajnë një rol kryesor në planifikimin dhe zbatimin e tyre.
- Familja është forca shtytëse duke u bazuar në pikat e forta dhe kompetencat e saj.
- Mbështetja e aftësive ekzistuese dhe zhvillimi i njohurive dhe aftësive të reja.

Praktikat me familjen në qendër përbëhen nga një grup i vlerave, qëndrimeve dhe qasjeve në shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre. Ato e pranojnë që familja është: Unike; Ekspertë për aftësitë dhe nevojat e fëmijës.

Qasja me familjen në qendër është efektive sepse është e rëndësishme që të gjithë ata që përfshihen ta kuptojnë në të njëjtën mënyrë se çfarë do të thotë një shërbim me familjen në qendër. Palët e përfshira janë: familjet, ofruesit e shërbimeve, mjekët, ekspertët, drejtorët e programeve dhe organizatat.

Është më e lehtë të flasim për një shërbim me familjen në qendër sesa ta zbatojmë atë.

Kjo kërkon trajnim për stafin që punon në këto shërbime. Praktika është e lidhur ngushtë me qëndrimet. Ne kemi nevojë për mundësi që reflektojnë atë që mendojmë dhe se si ndjehemi për mënyrën se si punojmë.

Pengesat e mundshme

- Stafi është i trajnuar të punojë vetëm me fëmijë dhe jo me të rritur;
- Pritshmëritë e familjeve;
- Pritshmëritë e menaxherëve të shërbimeve;
- Problemet kulturore;
- Problemet e kontrollit;
- Idetë e gabuara rreth shërbimit me familjen në qendër.

Parimet themelore të praktikave me familjen në qendër

- Familjet trajtohen me dinjitet dhe si pjesë përbërëse e jetës së fëmijës.
- Specialistët shfaqin ndjeshmëri ndaj larmisë familjare (racore, etnike, kulturore, socio-ekonomike).
- Zgjedhja dhe vendimi i familjes bëhet në të gjitha nivelet.
- Informacioni ndahet mbi baza të vazhdueshme, të plota dhe të paanshme (zgjedhje e informuar).
- Fokusi i ndërhyrjes përcaktohet nga familja.
- Mbështetja ofrohet në mënyrë fleksibile.
- Përdorimi i mjeteve të larmishme mbështetëse.
- Pikat e forta të familjeve përdoren si burime.
- Marrëdhëniet karakterizohen si partneritet dhe bashkëpunim midis një prindi/specialisti.
- Shërbimet dhe mbështetja e ofruar kanë për qëllim të fuqizojnë familjen.

Duke angazhuar familjet, mbështetja dhe asistencë janë më efektive.

Fuqizimi i familjeve nënkupton ofrimin e informacionit për ta dhe garantimin e të drejtave të tyre.

Ndërveprimi me familjet duhet të ndodhë në atë mënyrë, që ata të ruajnë ose të jenë të gatshëm të marrin kontrollin mbi jetët e familjeve të tyre dhe të përçojnë ndryshimet pozitive, të cilat vijnë nga ndërhyrja e hershme e bazuar në pikat e forta, aftësitë dhe veprimet e tyre. Familjet marrin vendime dhe bëjnë zgjedhje në lidhje me praktikën, burimet dhe ndërhyrjet që janë të përshtatshme për ta. Autonomia familjare ruhet ose përfordhet. Familja është e përfshirë në mënyrë aktive në mundësitë e dëshiruara.

Udhëzime kyçe për zhvillimin e sistemit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme në Kosovë

Rekomandohet që shteti i Kosovës të ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

Udhëzime për zhvillimin e politikave dhe legjislacionit për Ndërhyrje në Fëmijërinë e Hershme

- Hartimi i Ligjit për NFH për zhvillimin dhe zbatimin e sistemit të NFH-së;
- Hartimi i Strategjisë Nacionale dhe Planit të Veprimit për NFH;
- Hartimi i instrumenteve, rregulloreve, standardeve për shërbime dhe profesionistë si dhe dokumenteve të tjera për NFH;
- Hartimi i procedurave për bashkëpunim dhe koordinim horizontal dhe vertikal ndër-institucional.

Udhëzime për strukturat përgjegjëse për Ndërhyrje në Fëmijërinë e Hershme në nivelin nacional dhe lokal

- Përcaktimi i ministrisë udhëheqëse për të luajtur rol udhëheqës në planifikimin strategjik, për të mbledhur të gjithë palët dhe për të siguruar zhvillimin, miratimin dhe zbatimin e suksesshëm të politikave të NFH.
- Përcaktimi i ministrive të tjera përgjegjëse mbështetëse për zhvillimin dhe zbatimin e suksesshëm të politikave dhe programeve të NFH.
- Krijimi i një Komiteti Ndërsektorial për NFH, me kompetenca të përcaktuara. Kjo trupë duhet të hartojë analizën e situatës; të zhvillojë seminare konsultative në nivel komunal, rajonal dhe qendror; të mbajë konsultime me zyrtarë të lartë; të rishikojë dhe miratojë raportet për NFH; të ofrojë udhëzime për përgatitjen e instrumenteve, rregulloreve dhe dokumenteve të tjera për NFH; të mbajë konsultime publike me profesionistët dhe qytetarët për të shqyrtuar dokumentet ligjore; dhe të shqyrtojë dhe rishikojë të gjitha instrumentet për NFH.

- Komiteti Ndërsektorial për NFH raporton tek ministritë dhe të tjerët gjatë fazave të ndryshme të hartimit të dokumenteve për të siguruar që ata janë plotësisht të angazhuar gjatë hartimit të tyre.
- Ministritë dhe/ose Kuvendi miratojnë dhe monitorojnë zbatimin e dokumenteve ligjore dhe strategjike për NFH.
- Krijimi i Komiteteve lokale për NFH në komuna.

Financimi i Sistemit Kombëtar për Ndërhyrje në Fëmijërinë e Hershme

Gjatë përgatitjes së buxheteve për programin e NFH duhet të bëhen analiza fillestare të shërbimeve ekzistuese për fëmijët. Bazuar në analiza, duhet të përgatiten vlerësimet të cilat do të përdoren në përgatitjen e Planit të Veprimit për NFH, i cili përfshin buxhetet për të gjitha aktivitetet.

Qeveritë zakonisht ofrojnë mbështetje financiare për shpenzimet e vazhdueshme për shërbime/paga, sigurimin, trajnimin, mbikëqyrjen, monitorimin dhe vlerësimin për ofrimin e NFH, ndërsa burime të tjera të financimit kërkohen për kostot e inovacioneve të programit. Burime të tilla shpesh mund të jenë subvencione publike qendrore dhe lokale për programet e shërbimit, aktivitete të projektit, grante nga fondacionet, të ardhura nga llotaritë dhe nga taksat, mbështetje nga korporatat, bankat, bizneset dhe burime të tjera të sektorit privat, donatorë privat, donacione nga prindërit, ngjarje për mbledhjen e fondeve dhe shumë të tjera.

- Qeveria e Republikës së Kosovës bashkë me komunat duhet të financojnë shërbimet për NFH. Shërbimet e NFH mund të mbështeten edhe nga burime të tjera.

Avokimi për krijimin e një Sistemit Kombëtar për Ndërhyrje në Fëmijërinë e Hershme

Aktivitetet e avokimit për programin dhe politikën për NFH mund të jenë:

- Avokim për programin e NFH në nivel qendror dhe komunal;
- Kontribuim në hartimin e Ligjit dhe dokumenteve strategjike për NFH;
- Monitorim i zbatimit të legjislacionit dhe dokumenteve strategjike për NFH;
- Informim dhe vetëdijësim i institucioneve, profesionistëve dhe publikut për NFH;
- Avokim nga prindërit dhe organizatat e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Avokimi dhe komunikimi me publikun për politikën dhe ndërtimin e sistemit kombëtar të NFH është i domosdoshëm, për të ndihmuar të gjithë prindërit dhe qytetarët të kuptojnë përfitimet e shërbimeve të NFH.

Aktivitetet vetëdijësuese për publikun duhet të ndikojnë në ndërgjegjësimin e qytetarëve për pranimin e diversitetit, aftësive dhe kontributeve të të gjithë njerëzve, përfshirë kontributin dhe potencialin e personave me aftësi të kufizuara.

Përfundim

Zhvillimi i shërbimeve të NFH-së do të ketë ndikim pozitiv në shumë fusha:

- Shërbime cilësore, efektive dhe mbështetëse për fëmijë;
- Përkujdesje më e mirë prindërore;
- Shërbime të qasshme – rritje e numrit të fëmijëve që marrin shërbime;
- Integrim më i mirë i fëmijëve të cenueshëm;
- Profesionistë dhe kujdestarë të trajnuar;
- Politika dhe programe më të mira për fëmijët në nivel kombëtar dhe lokal;
- Përfshirje më aktive e shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse në lidhje me kujdesin dhe edukimin e fëmijëve.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF, është një koalicion i përbërë nga 29 organizata jo qeveritare vendore dhe ndërkombëtare të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, me mision të përbashkët avokimin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Koalicioni punon për promovimin, respektimin, mirëqenien, dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve, në përputhje me KDF.

www.komfkosova.org

Organizatat anëtare të KOMF janë:

Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim – ASTRA, Aksioni për Nëna dhe Fëmijë, Balkan Sunflowers Kosova, Childproof/CIPOF, Education Comes First – ECF, Iniciativa 6, Organizata Rinore Akti – Ora, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP, OPFAKKOS, Programi për të Drejtat Civile – CRP/K, PL4Y International, Qendra për Arsim e Kosovës – KEC, Qendra e Kujdesit Ditor PEMA, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të qenieve njerëzore – MVPT, Qendra për Studime të Avancuara – FIT, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT, Save the Children, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë – SDSF, Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK Kosova, Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës – HANDIKOS, Terre des hommes, The Ideas Partnership, VoRAE, World Vision, Public Organization for Local Initiatives and Supports – POLIS, Network of Peace Movement – NOPM, Qendra Sociale – Edukative SOS Kopshti dhe Nevo Koncepti.

“Karin Dom” është një organizatë jo-fitimprurëse e themeluar në vitin 1996, nga diplomati trashëgues dhe filantropisti Ivan Stancioff.

<https://karindom.org/en/>

Pas 23 vitesh të themelimit, Karin Dom është një organizatë me një rol lider në ofrimin e shërbimeve profesionale për fëmijët me nevoja të veçanta dhe familjet e tyre. Me kalimin e viteve, Karin Dom është zhvilluar e rritur si një qendër terapeutike për fëmijët me nevoja të veçanta, e cila punëson specialistë të kualifikimit të lartë: Fizioterapistë, rehabilitues, logoped, psikologë, mësues special, punëtorë social.

Aktivitetet kryesore janë të realizuara nga: Qendra për ofrimin e shërbimeve profesionale për fëmijët me nevoja të veçanta dhe familjet e tyre (për fëmijë të moshës 3-8 vjeç) Qendra për Ndërhyrje të Hershme (për fëmijë të moshës 0-3 vjeç) si dhe nga Qendra Burimore dhe e Trajnimeve (trajnime të kualifikuara për organizata dhe profesionistë). Karin Dom çdo vit mbështet mbi 300 fëmijë dhe familje si dhe trajnon mbi 1200 specialistë.



Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
Zenel Salihu, OB.1 HY.1 K.3 No.16, 10000
Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0) 38 220 287
www.komfkosova.org

Nëntor 2019

